

# Organizmi për Performancën – Përdorimi i Parametrave të Performancës për të Menaxhuar

Dr. Elaine Kamarck

Përgatitur për Qeverinë shqiptare

Nëntor, 2013

# Çfarë është Menaxhimi i Performancës?

- Menaxhimi i performancës është procesi me anë të të cilit krijohen qëllime ose objektiva statistikore kuptimplota dhe të dobishme, të cilat më vonë përdoren për të drejtuar funksionimin e përditshëm të organizimit.

# Përse përdoren Parametrat e Performancës për të menaxhuar?

- 1) Ata tregojnë se në ç'pikë projekti juaj është duke funksionuar dhe cilat janë pikat ku nuk po funksionon;
- 2) Parametrat shërbejnë si një mjet paralajmërimi i cili të ndihmon të evitosh, ose të paktën, të parandalosh problemet.

# Njësia e Jetësimit

- Parametrat e performancës janë një strategji inovative dhe janë në qendër të Njësisë së Jetësimit.
- Përcaktimi i parametrave dhe monitorimi i tyre do bëjë të mundur që Njësia e Jetësimit të drejtojë një nismë reforme gjithëpërfshirëse.

# 3 Hapat për të krijuar një Sistem Menaxhimi të Performancës

- 1) Përcaktimi i masave, p.sh. ekonomike, sasiore, cilësore
- 2) Bërja publike e të gjitha masave;
- 3) Përdorimi i masave për të rritur performancën dhe për të mësuar se si gjërat mund të bëhen më mirë.
- SHËNIM: Bëjeni të qartë faktin se NUK keni ndërmend të përdorni masat për të ndëshkuar punonjësit e Qeverisë.

# 1. Përcaktimi i masave:

- Nëse Qeveria nuk ka përdorur në të kaluarën një sistem masash, mund të fillojë ta bëjë këtë gjë duke kuptuar treguesit e përdorur nga grupet ndërkombëtare.

## 2. Bërja publike e gjithë masave


- Duke bërë publike masat, (sidomos masat e rezultatit) kryesia e Qeverisë dhe gjithë njësitë përkatëse do jenë të angazhuara në implementimin e tyre dhe publiku do i bëjë ata përgjegjës.

# 3. Përdorimi i masave...

- Parametrat e përcaktuar duhet të përdoren për të drejtuar aktivitetet e përditshme të organizatës.
- Ata nuk duhet të përdoren për të ndëshkuar njerëz, por duhet të shërbejnë që vëmendja e të gjithëve të përqëndrohet në rezultate.
- Parametrat duhet të jenë një mënyrë për të përmirësuar performancën dhe proceset.



# 3 blloqe parametrash për një menaxhim efektiv të performancës



# REZULTATE:

- Rezultatet janë diçka që qytetarët duan dhe mund të kuptojnë. Ata nuk janë të njëjtë me inputet dhe outputet.
- Për shembull: qytetarët duan rrugë të sigurta. Gratë duan që të mund të kthehen në shtëpi pas muzgut, pa patur frikë. Të paguash për më shumë policë nuk do të thotë që t'ia arrish qëllimit, nëse këto forca policie shtesë do punojnë gjatë ditës.

# OUTPUT:

- Outputet janë masa të ndërmjetme për punët që Qeveria është duke kryer.
- Për shembull: Për të luftuar krimin, një Qeverie mund t'i duhet të punësojë rreth 200 policë më shumë, por vetëm duke punësuar forca policie shtesë nuk është e thënë që do ketë “rezultate” për rrugë më të sigurta nëse, p.sh., këta policë do të punojnë me orar 9:00 – 17:00.

# INPUTE:

- Inputet kanë të bëjnë me shpenzimet e Qeverisë: tavolina, rroga, makina policie, armë, mjekime, etj.
- Inputet NUK janë garanci që njerëzit kanë marrë shërbimin e duhur.
- **SHEMBULL:** Një Qeveri është në gjendje të blejë vakcina poliomeliti të mjaftueshme për të vaksinuar të gjithë fëmijët. Por, nëse vaksinat vidhen dhe shiten në tregun e zi ose nëse shpërndahen në mënyrë të tillë që për fëmijët do të jetë e vështirë t'i marrin, a.t.h. ato nuk do i shërbejnë njerëzve. Nëse verifikohen këto raste, “inputi” nuk do ju çojë tek “rezultati”, i cili është: fëmijë të shëndetshëm të paprekur nga poliomeliti.

# Ja disa shembuj

- Rreth mënyrës sesi duhet menduar menaxhimi i performancës.
- SHËNIM: më poshtë do gjeni vetëm disa shëmbuj inputesh dhe outputesh.
- Çdo Ministri duhet ta bëjë këtë ushtrim së bashku me njësinë e saj të jetësimit.

# Turizmi

## Rezultati

- Në tregun ndërkombëtar Shqipëria të caktohet si një destinacion turistik i preferuar.

## Outpute

- Përmirësimi i cilësisë së ujit përgjatë bregut.
- Përmirësim në nivelin e pastërtisë së plazheve përgjatë bregut.
- Numri i dhomave të hotelit.

## Inpute

- Zhvillimi i një strategjie turizmi për periudhën 2014 – 2020.
- Shpallja e moratoriumeve për ndërtime në zonat e rëndësishme turistike.

# Sigurria për qytetarët

## Rezultate

- Gratë do mund të kthehen në shtëpi pas muzgut, pa qënë e nevojshme që të jenë të shoqëruara dhe pa patur frikë se mund të sulmohen dhe/ose vidhen.

## Outpute

- Numri i kriminelëve të arrestuar
- Numri i kriminelëve të dënuar dhe të burgosur

## Inpute

- Rrogat e policëve
- Armë dhe automjete për policët

# Shembull: Fëmijë të Shëndetshëm dhe të Zgjuar

- Fëmijë që rriten pa u prekur nga sëmundjet e parandalushme të fëmijëve

Rezultate

- Numri i fëmijëve që imunizohen çdo vit
- Numri i fëmijëve që kontrollohen çdo vit nga një profesionist i shëndetit

Outpute

- Numbri i dozave të blera për vaksinim
- Numri i infermierëve dhe i mjekëve që u shërbejnë fëmijëve, rrogat e tyre, pajisjet

Inpute



# Sigurria rrugore

## Rezultatee

- Ulja e numrit të të vdekurve në aksidente rrugore dhe e vetë aksidenteve.

## Outpute

- Rritja e numrit të shenjave rrugore si p.sh. vijat e bardha

## Inpute

- Investimi në sistemin e sinjalistikës rrugore në Shqipëri
- Investim në pastrimin e rrugëve
- Krijimi i një komiteti për sigurinë rrugore

# Përmirësimi i Arsimit

## Rezultate

- Fëmijët dhe adoleshentët shqiptarë duhet të arsimohen mirë, në mënyrë që të mund të konkurrojnë në sistemin universitar evropian.

## Outpute

- Numri i Kartave të performancës që janë krijuar në shkolla
- Numri i institucioneve arsimore që janë spastruar nga tregtia informale

## Inpute

- Përcaktimi i kriterëve të bazuara në meritokraci për emërimin e mësuesve dhe drejtorëve të shkollave.
- Njoftimi dhe hartimi i kartave të performancës shkollore

# Burime:

- Robert D. Behn, “Performance Leadership: 11 Practices that can Ratchet up Performance,” (IBM Center for the Business of Government, second edition, 2006)